



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1789/8 prot.,

Datë 06.08.2026

V E N D I M
Nr.945 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gjergj Mersini Nënkyetar
Edvin Simo Anëtar
Nertil Kanina Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.08.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga P.F “Naim Hysi”, ”3E COMPLEX” shpk dhe “Skyline SC” shpk në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-84266-05-05-2026, me objekt: “Blerje kosha mbetjesh për nevoja të Bashkisë Kolonjë, viti 2026” me fond limit 2,492,950.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 18-05-2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Luar Bros” shpk me NUIS L72322004M dhe Adresë: Rruga “Ali Demi” , Kompleksi Vind, Shkalla B, Kati 4, Apartamenti 11.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kolonjë, Adresë: Sheshi , “Rilindja ”.

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik P.F “Naim Hysi”, me NUIS L41726016Q dhe Adresë: Tirane, Rruga “e Dibrës”, Pallati Orion, KO, Privat, Nr 4 , Tirane1.

Operatori ekonomik “3E COMPLEX” shpk, me NUIS L41726016Q dhe Adresë: Rruga “Mihal G “, Tiranë.

Operatori ekonomik “Skyline SC” shpk, me NUIS M51624039U, dhe Adresë: Rruga “Tulla 3”, Z.K. 8320, Nr. pasurie 3/1431/ND, Njësia administrative nr.11, 1001

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021
“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,
ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik
Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave
“Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të
Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 07-05-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura Nr. REF-84266-05-05-2026, me objekt: “Blerje kosha mbetjesh për nevoja të Bashkisë Kolonjë, viti 2026” me fond limit 2,492,950.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 18-05-2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë.

II.2 Në datën 22.05.2026 autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin e ofertave dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Naim Hysi” PF	2,190,000	lekë kualifikuar
2. “3 E Complex” SHPK	2,250,000	lekë kualifikuar
3. “Skyline SC” SHPK	2,336,000	lekë kualifikuar
4. “Luar Bros” SHPK	2,372,500	lekë kualifikuar
5. “Optio” SHPK	2,409,000	lekë kualifikuar
6. “KEJ Group” SHPK	2,430,900	lekë kualifikuar

II.3 Në datën 02.06.2026 autoriteti kontraktor ka bërë publikimin e njoftim fituesit paraparak të procedurës së prokurimit në SPE .

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2026/ 6763, datë 05.06.2026 dhe me Nr.1789/2026 Prot., datë 08.06.2026 e operatorit ekonomik “Luar Bros” shpk duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomik të sipërcituar në objekt të këtij vendimi .

II.5 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1789/1 prot., datë 08.06.2026, janë publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me arsyet e pretendimeve të tij .

II.6 Më datë 30.04.2026 nga Bashkia Kolonjë, ka ardhur shkresa me nr.3506/1, datë 10.06.2026, protokolluar me tonën 1789/2 datë12.06.2026 me objekt “*Kthim përgjigje...*”, në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik , për procedurën objekt – ankimi, ku rezulton, se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar këtë të fundit.

II.7 Më datë 26.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1789/3 prot., Bashkia Kolonjë, ka përcjellë shkresën me nr.3506/1, datë 10.06.2026, me objekt “*Kthim përgjigje...*”, në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik , për procedurën objekt – ankimi, ku rezulton, se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar këtë të fundit.

II.8 Më datë 03.07.2026, protokolluar me tonën nr. 1789/4 prot., Bashkia Kolonjë, ka përcjellë shkresën me nr.3506/1, datë 10.06.2026, me objekt “*Kthim përgjigje...*”, në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik , për procedurën objekt – ankimi, ku rezulton, se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar këtë të fundit.

II.8 Më datë 29.07.2026, protokolluar me tonën nr. 1789/5 prot., Bashkia Kolonjë, ka përcjellë shkresën me nr.4908 , datë 27.07.2026, me objekt “*Ridërgim kthim përgjigje...*”, në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik , për procedurën objekt – ankimi, ku rezulton, se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar këtë të fundit.

II.7 Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1 Lidhur me arsyet pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Luar Bros” shpk, për operatorët ekonomik P.F “Naim Hysi”; “3E COMPLEX” shpk dhe “Skyline SC” shpk si në vijim:

- [...Në këtë procedurë prokurimi Autoriteti Kontraktor ka kualifikuar operatorët ekonomik P.F Naim Hysi; 3E COMPLEX SHPK dhe Skyline SC SHPK në kundërshtim me parashikimet ligjore. Nga verifikimi në faqen e <https://qkb.gov.al/kerko-per-subjekt/> që kërkon informacione rreth operatoreve ekonomik, shihet fare mirë se operatori ekonomik P.F Naim Hysi; 3E COMPLEX SHPK dhe Skyline SC SHPK nuk ushtrojnë ne fushen e veprimtarisë, aktivitete sipas objektit të prokurimit. Në objektin e veprimtarisë së tij P.F Naim Hysi rezulton se ka objekt të aktivitetit të tij: Shtypshkrime dhe tregetim i artikujve sportiv, librave artistike dhe shkollore. Prodhim dhe tregetim mobiliesh dhe paisje zyresh. Tregti me pakice i artikujve ushqimore, kozmetike, detergjente pesticide, vegla pune, kancelari, guzhine, materiale hidrosanitare. Materiale pastrimi dhe sherbime higjeno-shendetesore, dizinfiktimi, deratizimi, dizinsekti. Pastrim e mirembajtje ambienti. Sherbime hotelerie, lavaxie. Materiale dhe punime elektrike, hidraulike, ndertimi, konstruksione metalike dhe druri. Tregtim lulesh dhe pemesh dekorative, sherbim dekorimi, gjelberimi. Tregtim i pjeseve per automjete dhe sherbim servisi. Prodhim dhe tregtim i produkteve te tekstileve dhe konfeksione te ndryshme. Tregtim dhe mirembajtje kompjuterash. Shfrytezim i lendeve drusore e transport. Transport per vete dhe te trete, per mallra dhe pasagjere. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike. Aktiviteteve sportive. Sherbime audio, video, foni profesionale, ndriçim profesional, ledëalle etj. Aktivitet ne fushen e reklames, materiale te tjera publicitare. Prodhim, shperndarje dhe riprodhim reklamash. Tregtim artikuj ushqimor me shumice dhe pakice. Tregtim te te gjitha produkteve bujqesore organike dhe inorganike, inute bujqesore si dhe pesticide, punime te ndryshme ne bujqesi. Tregtim i materialeve dhe bazes ushqimore te peshkimit. Tregtim tubash rekorderie, riparim pompa, elektropompa si dhe mirembajtja e tyre. Tregtim dhe mirembajtje te pajisjeve te kondicionimit 17 18 (ngrohje, ftohje). Tregtimi tapeteve, moketeve, parketeve, shtresa PVC, prodhim te grilave te brendeshme dhe te jashtme per dritare, si dhe tendave te diellit. Sinjalistike rrugore. Prodhim dhe tregtim i dyerve dhe dritareve prej druri dhe duralumini. Lyerje objektesh. Akomodim sherbime kokteile dhe katering. Sherbim hoteli, restoranti, bari. Sherbime ne fushen e turizmit si udhetime brenda dhe jashte vendit. Furnizim dhe mirembajtje te materialeve dhe pajisjeve te telekomunikacionit, elektronike, mekanike, elektro-mekanike, hidraulike, elektroshtepiake .Shitje me shumicë te karburanteve dhe te tjera materiale për ngrohje . Tregti me shumicë e pakicë pajisjesh laboratorike, kimikateve e reagentëve laboratorike. Pajisje industriale

per prodhim kimikatesh. Tregetim i materialeve dhe paisjeve didaktike, logopedike,shkolllore.Tregetimi i automjeteve te ndryshme,pjeseve te kembimit,goma,bateri,vajra lubrifikante,alkool,filtra,antifrizë,graso etj.Instalim dhe riparim i sistemeve te ngrohjes dhe ftohjes.Servis dhe mirembajtje kalidajash. (deri në 18.05.2026, datë për paraqitjen e ofertës ekonomike) Në objektin e veprimtarisë së tij subjektit 3E COMPLEX rezulton se ka objekt të aktivitetit të tij: Tregti me shumice e pakice e artikujve te ndryshem, elektrike hidraulike.Punime te specializuara te ndertimeve. Kancelari;Tregti mallrash dhe materialesh te ndryshme;Tregtim te pjeseve te automjeteve, transporte mallrash brenda dhe jashte vendit.Sherbim Pastrimi dhe gjelberimi, sherbime nderhyrese higjenosanitare,sherbim dhe pastrim te te gjitha ambienteve private dhe shteterore.Riparim dhe montim kompjuterash dhe kamera sigurie. Importe Eksporte, tregti me shumice dhe pakice.Tregti te detergjenteve.Sherbim catering.Shitje te produkteve tekstile dhe konfeksioneve te ndryshme. Tregtim me shumice dhe pakice te artikujve ushqimore.Lavazho te automjeteve dhe tapicerive te ndryshme. Rimbushje te fiskseve te zjarrit, dhe tregtia e tyre. Materiale laboratorike, biologjike, zoologjike.Sherbime montimi dhe riparime kondicionerash.Sherbim pastrimi kanalesh kulluese dhe shtrirje linjash i nterkonjeksioni.Punime te ndryshme te profileve metalike, Punime te ndryshme druri dhe nen produkte te tij.Tregti me shumice pampersave te konfeksioneve te ndryshme. (deri në 18.05.2026, datë për paraqitjen e ofertës ekonomike) Në objektin e veprimtarisë së tij subjektit Skyline SC rezulton se ka objekt të aktivitetit të tij: Shërbime dhe konsulencë financiare shërbime dhe konsulencë marketingu Tregti me pakice I artikujve dhe materialave te ndryshem detergjente profesionale elektrike hidraulike, kancelari dhe sherbime nepermjet internetit Tregti per pajisje elektronike aparate celulare kompjuter printer Organizim eventesh catering Sherbim servis automjeteve pjese kembimi import export makinash e mallrash te ndryshme printimi dhe stampimi Sherbime dyer alumin Punime te specializuara te ndertimeve per biznese e individe. Lavazh automjeteve Tregti produkteve ushqimore tekstile dhe industriale Ndertim dhe mirembajtje ashensori Transport mallrash Brenda dhe jashte vendit sherbime pastrime gjelberimi Të organizojë trajnime të importojë dhe të eksportojë mallra dhe shërbime dhe çdo veprimtari Vleresim i pasurive te paluajteshme Projektme te veprave te ndryshme Konsulence Juridike Prodhim materiale ndertimi prodhim dyer-dritare duralumini Vleresim i Ndikimit ne Mjedis Auditim i efijences se energjise ne ndertesa Ndërtim montim, restaurim objektsh punime dheu murature betoni asfalti punime shembje ndërtime civile industriale bujqësore detare turistike punime në rrugë ura hekurudh punime strukture speciale punime mirëmbajtje diga punime nëntokësore e vepra arti ujësjellësa kanalizime gazsjellësa vepra kullimi e vaditje prodhim e tregtim të materialeve të ndryshme të ndërtimit import, eksport të artikujve industrialë ushqimorë makineri pajisje materiale të ndërtimit pastrim grumbullim transport pastrim të ujrave lumore liqenore e detare mbrojtje mirëmbajtje pyjesh e pastrim kullotash punime rifiniture, veshje fasadash lysterje konstruksione metalike e druri impiante elektrike telekomunikacioni teknologjike, punime në kabina elektrike nënstacione punime të sinjalistikës rrugore ndriçuese e jo ndriçuese montim strukturash mekanike transport kombëtar e ndërkombëtar në mënyrë tokësore ose detare edhe për të tretë Rikonstruksione banesash Mirëmbajtje e pastrim godinash civile tregtare shëndetësore turistike Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbëruara Veshje fasada Prodhim dhe tregtim i duraluminit për dyer dritare vetrata grila e aksesore të tjerë Punime në varrezat publike dhe ato të dëshmorëve Punime hidraulike Tregtim me shumicë dhe pakicë i elektroshtëpiakeve Përpunim i lëndës drusore Transport mallrash dhe pasagjerësh Tregtim të rërës bituminoze, asfaltobetoni dhe produkteve asfaltme, vajra motorike për makineri dhe mjete

transporti, bojra, materiale hidraulike dhe pajisje hidrosanitare dhe elektronike, vegla pune. Projektim dhe instalime te pajisjeve per sisteme ngrohje-ftohje chiller dhe fan-coil riparim dhe montim kaldajash dhe kondicioneresh Instalim panele diellore sisteme fotovoltaike tregti te materialeve hidraulike mjeteve te pastrimit elektroshtepiake dhe sherbime te ndryshme lyerje te brendshme dhe jashtme tregtim produktesh ushqimore kinkalerie mjeteesh pastrimi detergjentësh lëndë pastrimi bimë dekorative lule humus dhe dru zjarri Tregti materiale industriale veshmbathje tuba betoni tuba plastike materiale mobilerie, bojra printer, letra dhe materiale kancelarie. Riprodhim dhe tregti elektromekanike tregti kompjuterash Ene guzhine Tregtim kozmetike tregtim per zjarrfikese dhe rimbushjen e tyre 2 tregtim te materialeve sinjalistike dhe reklama, te librave dhe fletoreve artistike dhe shkollore Tregti te gomave, te metrazheve tapeteve dhe moketeve, lendeve drusore, makinerive dhe mjeteve bujqesore si dhe pesticideve te pllakave dhe gure decorative. Ndertim te sistemit te vaditjes Transport mallrash dhe udhetaresh per vete dhe te trete Tregtim te materialeve te sigurise kamerave dhe montimi i tyre materiale elektronikemateriale laboratorike veshje sportive dhe veshje pune sherbim pastrimi dhe dizenfiktimi, mobiljesh dhe mobileri zyre, mjete didaktike, te materialeve te fonderise Sherbim larje automjeteesh. Tregtim soba ngrohje dhe llojeve te tjera,peleti dhe gazi te lengshem per ngrohje,kafeje dhe uji te pijshem Sherbim akomodimi hotelierie dhe katering me nenkontrate Sherbim i dhenies me qera te makinave Transport karotreci Servis i mjeteve motorike me nenkontrate Shtypshkrim i blloqeve dhe regjistrave Tregtim i materialeve dekorative per ambjentet e brendshme e jashtme Import dhe tregtim i makinava Shfrytëzim i lendeve drusore Prodhim dhe riparim i dyerve dhe dritareve prej druri alumini dhe hekuri si dhe mekanizmave automatik te tyre Prodhim dhe tregtim i qepenave prej xingate dhe duralumini Tregtim i imputeve bujqesore dhe plehrave kimike e organike Organizim i aktiviteteve kulturore dhe artistike Sherbim audio dhe videofoni Tregtim i materiale dhe bazes ushqimore per peshkim Prodhim dhe tregtim i grilave te brendshme e jashtme per dritare si dhe i tendave te diellit Tregtim te maskave mbrojtese ,dorezave dhe dezifektante si xhel alkol etilik klor i lengshem , materiale per stervitje,materialesh BCU, dhe montim i pompave te ujit, i dezinfektanteve. Botime printime dhe shtypshkrime Printim banerash Logim materialesh te ndryshme Tregtim solucionesh per radiologji dhe ekografi Materiale pastirmi. Tregtimin e reagenteve laboratorike, pajisjeve laboratorike, tregtimin e pajisjeve dentare si dhe cdo aktivitet qe ka lidhje me to.Larje,pastrim,lavazh,blerje material mjeksore e labratorike (deri në 18.05.2026, datë për paraqitjen e ofertës ekonomike) Objekti i veprimtarisë së kësaj procedure prokurimi Blerje kosha mbetjesh për nevoja të Bashkisë Kolonjë,viti 2026 , ku identifikimi i Kodit sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP) është: 39224340-3, me emertimin Kosha mbeturinash . Shifet farë qartë se tre operatorët e parë ekonomik të kualifikuar P.F Naim Hysi, 3E COMPLEX SHPK dhe Skyline SC SHPK, sipas ekstraktit të regjistrat tregtar nuk konstatohet në asnjë rresht, të kenë në objektin e aktivitetit /veprimtarisë objektin e kësaj procedure prokurimi. Objekt i prokurimit nuk përfshihet në asnjë nga fushat e veprimtarisë ku ushtrojnë aktivitet Operatorët Ekonomik P.F Naim Hysi; 3E COMPLEX SHPK dhe Skyline SC SHPK. Dhe si rrjedhoje këta operator ekonomik nuk kanë lidhur kontrata te ngjashme me asnje Autoritete Kontraktore Publike/Shtetore per ofrimin e sherbimeve te ngjashme me kete procedure prokurimi. Autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesve P.F Naim Hysi, 3E COMPLEX SHPK dhe Skyline SC SHPK dhe përzgjedhjen e tij nuk e ka bërë në përputhje me vetë kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, duke kualifikuar në këtë mënyrë operatorët ekonomik të cilët nuk disponojnë dokumentacionin ligjor mbi plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe kriterëve të

vecanta të kualifikimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papraneshme. Autoriteti kontraktor duhet të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, operatorët ekonomik nuk plotësojnë kriterin shtojcën 8 a) Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit dhe duhet të skualifikohen. Për sa vijon arsyetimin tonë Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kolonjë duhet të kryente verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatorët Ekonomik sipas shtojcës 9. Akoma me tej operatorët ekonomik kanë dhënë deklaram të pasaktë në formularin e vetëdeklarimit i cili përbën shkak për përjashtim nga prokurimet publike sipas përcaktimeve të nenit 26 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, ku parashikohet se: Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik], Komisioni i Prokurimit Publik vë re se,

III.1.1 Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi autoriteti kontraktor ka parashikuar, si më poshtë:

Shtojca 8.

1. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. Kriteret e veçanta të kualifikimit

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

III.1.2. Në shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit , në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se: Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT Deklarata Operatorit ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e aktiv. një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin Sqarime nëse vlerësohet _____ e nevojshme .


III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatorët ekonomik “Skyline SC” SHPK; “Naim Hysi” PF; dhe “3E COMPLEX” SHPK për përmbushjen e kërkesave të mësipërme, rezulton se këto të fundit kanë paraqitur dokumentacion në SPE si më poshtë vijon:

- Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, operatori ekonomik “Skyline Sc” shpk, si në vijim:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: www.e-albania.al Autoritetin ose organin lëshues: QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT Lloji i dokumentit: Çertifikatë Regjistrimi, Ekstrakti Tregtar, Ekstrakti Historik



- Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 operatori ekonomik “Naim Hysi” pf si në vijim:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Ekstrakt Tregtar nga QKB (e-albania) Operatori Ekonomik NAIM HYSI P.F është i regjistruar ne regjistrin tregtar sipas legjislacionit, ka ne fushen e veprimtarise se saj objektin e prokurimit si dhe ka statusin aktiv.

- Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8 operatori ekonomik “3E Complex” shpk si në vijim:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Adresën e ueb-it: [https://qkb.gov.al/ https://e-albania.al/]
Autoritetin ose organin lëshues: [QKB]
Lloji i dokumentacit: [Ekstrakt i Regjistrit tregtar, Ekstrakt historik i regjistrit tregtar, Vërtetim për statusin Aktiv/Pasiv/të Tjerë]

II.1.4. Neni 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” i VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: *“Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Këto kriteret synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.”*

III.1.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; 20 b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për 6 shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.6. Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.8. Neni 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” i VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Këto kriteret synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.”

III.1.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur

përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të 21 gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.10. Lidhur me arsyen e pretendimeve të operatorit ekonomik “Luar bros” shpk, për sa i përket objektit të veprimtarisë së operatorit ekonomik ekonomik “Naim Hysi” PF; “3E COMPLEX” SHPK dhe “Skyline SC” SHPK, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik në fjalë rezulton, se në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, gërma “A” “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, është deklaruar si në pikën III. 1. 3 të këtij vendimi .

Komisioni i prokurimit publik, vlerëson se referuar formularit të vetdeklarimit si nga verifikimi i ekstraktit historik të regjistrit për të dhënat e subjekteve përkatësisht: “Naim Hysi” PF; “3E COMPLEX” SHPK dhe “Skyline SC” SHPK, të ngarkuar në sistemin elektronik SPE rezulton, se objekti i aktivitetit për operatorin ekonomik - **“Naim Hysi” pf** është përcaktuar: “Shtypshkrime dhe tregtim i artikujve sportiv, librave artistike dhe shkollore. Prodhim dhe tregtim mobilie dhe paisje zyrash. Tregti me pakice i artikujve ushqimore, kozmetike, detergjente pesticide, vegla pune, kancelari, guzhine, materiale hidrosanitare. Materiale pastrimi dhe sherbime higjieno-shendetesore, dizinfektimi, deratizimi, dizinsektimi. Pastrim e mirembajtje ambienti. Sherbime hotelerie, lavanterie. Materiale dhe punime elektrike, hidraulike, ndertimi, konstruksione metalike dhe druri. Tregtim lulesh dhe pemesh dekorative, sherbim dekorimi, gjelberimi. Tregtim i pjeseve per automjete dhe sherbim servisi. Prodhim dhe tregtim i produkteve te tekstileve dhe konfeksione te ndryshme. Tregtim dhe mirembajtje kompjuterash. Shfrytezim i lendeve drusore e transport. Transport per vete dhe te trete, per mallra dhe pasagjere. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike. Aktiviteteve sportive. Sherbime audio, video, foni profesionale, ndricim profesional, ledëalle etj. Aktivitet ne fushen e reklames, materiale te tjera publicitare. Prodhim, shperndarje dhe riprodhim reklamash. Tregtim artikuj ushqimor me shumice dhe pakice. Tregtim te te gjitha produkteve bujqesore organike dhe inorganike, inpute bujqesore si dhe pesticide, punime te ndryshme ne bujqesi. Tregtim i materialeve dhe bazes ushqimore te peshkimit..” - Për operatorin ekonomik **“3E COMPLEX” SHPK** është e përcaktuar : “Tregti me shumice e pakice e artikujve te ndryshem, elektrike hidraulike.Punime te specializuara te ndertimeve. Kancelari;Tregti mallrash dhe materialeve te ndryshme;Tregtim te pjeseve te automjeteve, transporte mallrash brenda dhe jashte vendit.Sherbim Pastrimi dhe gjelberimi, sherbime nderhyrese higjenosanitare,sherbim dhe pastrim te te gjitha ambienteve private dhe shtetore.Riparim dhe montim kompjuterash dhe kamera sigurie. Importe-Eksporte, tregti me shumice dhe pakice.Tregti te detergjenteve.Sherbim catering.Shitje te produkteve tekstile dhe konfeksioneve te ndryshme. Tregtim me shumice dhe pakice te artikujve ushqimore.Lavazho te automjeteve dhe tapicerive te ndryshme. Rimbushje te fiskseve te zjarrit, dhe tregtia e tyre. Materiale laboratorike, biologjike, zoologjike.Sherbime montimi dhe riparime kondicionerash.Sherbim pastrimi kanalesh kulluese dhe shtrirn linjash i nterkonjeksioni.Punime te ndryshme te profileve metalike, Punime te ndryshme druri dhe nen produkte te tij. - Për operatorin ekonomik **“Skyline SC” shpk** është përcaktuar: “Shërbime dhe konsulencë financiare shërbime dhe konsulencë marketingu Tregti me pakice I artikujve dhe

materialave te ndryshem detergjente profesionale elektrike hidraulike, kancelari dhe sherbime nepermjet internetit Tregti per pajisje elektronike aparate celulare kompjuter printer Organizim eventesh catering Sherbim servis automjetesh pjese kembimi import export makinash e mallrash te ndryshme printimi dhe stampimi Sherbime dyer alumin Punime te specializuara te ndertimeve per biznese e individe. Lavazh automjetesh Tregti produkteve ushqimore tekstile dhe industrial Ndertim dhe mirembajtje ashensori Transport mallrash Brenda dhe jashte vendit sherbime pastrime gjelberimi Të organizojë trajnime të importojë dhe të eksportojë mallra dhe shërbime dhe çdo veprimtari Vleresim i pasurive te paluajteshme Projektme te veprave te ndryshme Konsulence Juridike Prodhim materiale ndertimi prodhim dyer-dritare duralumini Vleresim i Ndikimit ne Mjedis Auditim i efçences se energjise ne ndertesa Ndërtim montim, restaurim objekteve punime dheu murature betoni asfalti punime shembje ndërtime civile industriale bujqësore detare turistike punime në rrugë ura hekurudh punime strukturore speciale punime mirëmbajtje diga punime nëntokësore e vepra arti ujësjellësa kanalizime gazsjellësa vepra kullimi e vaditje prodhim e tregtim të materialeve të ndryshme të ndërtimit import, eksport të artikujve industrialë ushqimorë makineri pajisje materiale të ndërtimit pastrim grumbullim transport pastrim të ujrave lumore liqenore e detare mbrojtje mirëmbajtje pyjesh e pastrim kullotash punime rifiniture, veshje fasadash lysterje konstruksione metalike e druri impiante elektrike telekomunikacioni teknologjike, punime në kabina elektrike nënstacione punime të sinjalistikës rrugore ndriçuese e jo ndriçuese montim strukturash mekanike transport kombëtar e ndërkombëtar në mënyrë tokësore ose detare edhe për të tretë Rikonstruksione banesash Mirëmbajtje e pastrim godinash civile tregtare shëndetësore turistike Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbëruara Veshje fasada Prodhim dhe tregtim i duraluminit për dyer dritare vetrata grila e aksesore të tjerë Punime në varrezat publike dhe ato të dëshmorëve Punime hidraulike Tregtim me shumicë dhe pakicë i elektroshtëpiakeve Përpunim i lëndës drusore Transport mallrash dhe pasagjerësh Tregtim të rërës bituminoze, asfaltobetoni dhe produkteve asfaltme, vajra motorike për makineri dhe mjete transporti, bojra, materiale hidraulike dhe pajisje hidrosanitare dhe elektronike, vegla pune. Projektim dhe instalime te pajisjeve per sisteme ngrohje-ftohje chiller dhe fan-coil riparim dhe montim kaldajash dhe kondicioneresh Instalim panele diellore sisteme fotovoltaike tregti te materialeve hidraulike mjeteve te pastrimit elektroshtepiake dhe sherbime te ndryshme lysterje te brendshme dhe jashtme tregtim produkteve ushqimore kinkalerie mjeteve pastrimi detergjentësh lëndë pastrimi bimë dekorative lule humus dhe dru zjarri Tregti materiale industriale veshmbathje tuba betoni tuba plastike materiale mobilerie, bojra printer, letra dhe materiale kancelarie. Riprodhim dhe tregti elektromekanike tregti kompjuterash Ene guzhine Tregtim kozmetike tregtim per zjarrfikese dhe rimbushjen e tyre tregtim te materialeve sinjalistike dhe reklama, te librave dhe fletoreve artistike dhe shkollore Tregti te gomave, te metrazheve tapeteve dhe moketeve, lendeve drusore, makinerive dhe mjeteve bujqesore si dhe pesticideve te pllakave dhe gure decorative. Ndertim te sistemit te vaditjes Transport mallrash dhe udhetaresh per vete dhe te trete Tregtim te materialeve te sigurise kamerave dhe montimi i tyre materiale elektronikemateriale laboratorike veshje sportive dhe veshje pune sherbim pastrimi dhe dizenfiktimi, mobiljesh dhe mobileri zyre, mjete didaktike, te materialeve te fonderise Sherbim larje automjetesh. Tregtim soba ngrohje dhe llojeve te tjera,peleti dhe gazi te lengshem per ngrohje,kafeje dhe uji te pijshem Sherbim akomodimi hotelierie dhe katering me nenkontrate Sherbim i dhenies me qera te makinave Transport karotreci Servis i mjeteve motorike me nenkontrate Shtypshkrim i blloqeve dhe regjistrave Tregtim i materialeve dekorative per ambjentet e brendshme e jashtme Import dhe tregtim i makinave Shfrytezim i lendeve drusore Prodhim dhe riparim i dyerve dhe dritareve prej

druri alumini dhe hekuri si dhe mekanizmeve automatik te tyre Prodhim dhe tregtim i qepenave prej xingate dhe duralumini Tregtim i imputeve bujqesore dhe plehrave kimike e organike Organizim i aktiviteteve kulturore dhe artistike Sherbim audio dhe videofoni Tregtim i materiale dhe bazes ushqimore per peshkim Prodhim dhe tregtim i grilave te brendshme e jashtme per dritare si dhe i tendave te diellit Tregtim te maskave mbrojtese ,dorezave dhe dezinfektante si xhel alkol etilik klor i lengshem , materiale per stervitje,materialesh BCU, dhe montim i pompave te ujit, i dezinfektanteve. Botime printime dhe shtypshkrime Printim banerash Logim materialesh te ndryshme Tregtim solucionesh per radiologji dhe ekografi Materiale pastirmi. Tregtimin e reagenteve laboratorike, pajisjeve laboratorike, tregtimin e pajisjeve dentare si dhe cdo aktivitet qe ka lidhje me to.Larje,pastrim,lavazh,blerje material mjeksore e laboratorike.”.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, në analizë dhe vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë **“Skyline SC” sh.p.k., “3E COMPLEX” sh.p.k. dhe “Naim Hysi” pf**, si dhe nga verifikimi i të dhënave të regjistrimit të operatorit ekonomik në regjistrin tregtar rezulton se objekti i veprimtarisë së tyre është i gjerë dhe përfshin, ndër të tjera, tregtinë me shumicë dhe pakicë të artikujve dhe materialeve të ndryshme, tregtinë e produkteve industriale, importin dhe eksportin e mallrave të ndryshme, si dhe tregtimin e materialeve dhe pajisjeve të përdorimit të përgjithshëm. Komisioni vlerëson se objekti i procedurës së prokurimit, i cili konsiston në blerjen e koshave për mbetje, përbën furnizim me mallra industriale dhe, për rrjedhojë, përfshihet në mënyrë të natyrshme brenda objektit të veprimtarisë së operatorit ekonomik. Fakti që në objektin e regjistruar nuk përmendet në mënyrë të posaçme termi "kosha për mbetje", nuk përbën shkak për të arritur në përfundimin se operatorët ekonomikë nuk e kanë të drejtën të ushtrojë këtë aktivitet, për sa kohë objekti i tyre përfshin tregtimin e artikujve, mallrave dhe produkteve industriale të ndryshme. Komisioni gjykon se interpretimi i objektit të veprimtarisë duhet të bëhet në përputhje me përmbajtjen dhe qëllimin e tij, duke marrë në konsideratë natyrën e mallrave që prokurohen dhe jo vetëm përmendjen e tyre në formë nominale si zë të posacëm në ekstraktin historik të regjistrit tregtar. Për rrjedhojë, blerja dhe tregtimi i koshave për mbetje përbën një aktivitet që mbulohet nga objektet e veprimtarisë së operatorëve ekonomik, ndaj nuk rezulton se ekziston mospërputhje ndërmjet objektit të prokurimit dhe objektit të veprimtarisë së operatorëve ekonomikë sipërcituar. Në këto kushte, Komisioni çmon se pretendimet lidhur me mungesën e përputhshmërisë së objektit të veprimtarisë janë të pabazuara dhe nuk përbëjnë shkak për skualifikimin e operatorëve ekonomik.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, në analizë dhe vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë **“Skyline SC” sh.p.k., “3E COMPLEX” sh.p.k. dhe “Naim Hysi” pf**, çmon se dokumentacioni i depozituar prej tyre është në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit. Ky konkluzion mbështetet në verifikimin e dokumentacionit administrativ dhe ligjor të paraqitur nga secili operator ekonomik, si dhe në shqyrtimin e përmbushjes së kërkesave të kualifikimit të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit.

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **“Luar bros” shpk** nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e*

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Luar Bros” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-84266-05-05-2026, me objekt: “Blerje kosha mbetjesh për nevoja të Bashkisë Kolonjë, viti 2026” me fond limit 2,492,950.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 18-05-2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë.
2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapat procedural të procedurës së sipërpërmendur .
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë derdhjen në buxhet të shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Luar Bros ”shpk.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Nënkryetar
Gjergj Mersini